



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë më, 13.12.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Vijimi i shqyrtimit nen per nen i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”
2. Shqyrtimi nen per nen i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”
3. Shqyrtimi nen per nen i projektligjit “Per Buxhetin e vitit 2020”

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Arben Elezi, Evis Kushi, Anastas Angjeli, Suzana Topi,
Reme Lala, Ervin Bushati, Blerina Gjylameti, , Xhavit Bushaj, Roland Xhelilaj, Senida Mesi, Vullnet Sinaj, Eljo Hysko, Edlira Hyseni, Artur Roshi, Krenar Ryçi, Korab Lita, Ylli Shehu.

Mungojnë:

Antoneta Dhima,

Te ftuar

Ministria e Financave dhe Ekonomise

1. Zv/Ministri Z. Elton Haxhi

2. Z. Nikolla Lera Drejtor I Pergjithshem
3. Znj. Mimoza Dhembli Drejtoreshe e Pergjithshme e Buxhetit,
4. Znj. Suzana Stefa Drejtoreshe e Investimeve Publike,
5. Z. Gentian Opre Drejtor I Analizës dhe Programimit Buxhetor,
6. Z. Fran Brahimi Drejtor i Financave Vendore,
7. Znj. Ina Dhaskali P/sektori tek Programimi Buxhetor,
8. Znj. Vilma Causholli P/sektori tek Analiza Buxhetore.
9. Enkeleda Pipa
10. Enkeleda Kuci
11. Dorjana Toro
12. Ilir Sallaku

HAPET MBLEDHJA

Anastas Angjeli – Atëherë, le të fillojmë!

Dhe kemi mbetur te neni 4 E miratuam

Neni 5 nuk ka ndryshime Ka njeri pyetje?

Arben Ahmetaj – Atëherë, ta votojmë nenin 5, në qoftë se s'ka pyetje.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Anastas Angjeli – Neni 6.

Dua t'ju bëj edhe një herë me dije, se nga neni 6 deri te neni 16, nuk ka ndryshime, kështu që, nëse keni ndonjë gjë në lidhje me secilin nga këto nene, mund të më thoni. Do t'i kalojmë një për një, meqë nuk ka ndryshime nga versioni i qeverisë, sepse janë në rregull Megjithatë, po të keni ndonjë gjë në lidhje me nenet nga 6 deri në 16, mund të na ndërprisni, si mua, ashtu edhe zotin Ahmetaj.

Atëherë, neni 6 ka ndonjë sugjerim në lidhje me këtë nen?

Nuk ka gjë. Hidhet në votim neni 6.

Arben Ahmetaj – Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Anastas Angjeli – Neni 7 është po ashtu në këtë frymë. Ka ndokush propozim? Po pyetje? S’ka. Hidhe në votim, Beni.

Arben Ahmetaj – Në rregull!

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Anastas Angjeli – Neni 8 Nuk ka ndryshim. Ka ndokush ndonjë sugjerim a pyetje? Janë vetëm rregullime.

Arben Ahmetaj – Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Anastas Angjeli – Neni 9 ka vetëm një shfuqizim të nenit 102.

S’ka pyetje.

Arben Ahmetaj – Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Anastas Angjeli – Neni 10 ka një rregulli sa i përket mënyrës së lëshimit dhe dërgimit të faturave.

Nuk ka vërejtje. Ka pyetje?

Arben Ahmetaj – Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Anastas Angjeli – Neni 11 është në vazhdim të nenit të mëparshëm, në lidhje me kriteret e dërgimit dhe të lëshimit të faturave.

Nuk ka vërejtje.

Arben Ahmetaj – Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Anastas Angjeli – Neni 12 ka dy ndryshime

Nëse keni vërejtje, mund ta thoni.

Arben Ahmetaj – Neni 12. Ka pyetje? S’ka.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Anastas Angjeli – Neni 13. Ka një rregullim të procedurës ligjore. Nuk kemi vërejtje. Kush ka vërejtje, le t’i thotë.

Arben Ahmetaj – Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Anastas Angjeli – Neni 14 ka vetëm një ndryshim të vogël. Vërejtje nuk ka.

Arben Ahmetaj – Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Anastas Angjeli – Neni 15 shfuqizon pikën 2 të nenit 157, me ndryshimet që janë bërë edhe në ligjet e mëparshme. Vërejtje s’ka.

Arben Ahmetaj – Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Anastas Angjeli – Neni 16. Te ky nen ka dy ndryshime, prandaj do t’ju sugjeroja që të kini vëmendjen.

Në paragrafin hyrës të nenit 16, fjalët: “zbatimit të tij” të zëvendësohen me “efekte të dispozitave lidhur me”. Në shkronjat ‘a’, ‘b’ dhe ‘c’, fjalët: “sipas përcaktimeve të parapara hyrjes në fuqi të këtij ligji” do të zëvendësohen me: “sipas përcaktimeve deri në datën e fillimit të efekteve të dispozitave respektive të këtij ligji”.

Kush ka vërejtje apo pyetje?

Arben Ahmetaj – Ka pyetje?

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Anastas Angjeli – Tani kemi hyrjen në fuqi, që është edhe neni i fundit.

Tani, këtu duhet të kemi parasysh se është neni që përcakton hyrjen në fuqi, ku thuhet: “Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare”.

Përfundimisht nga përcaktimi i pikës 1, neni 2 i këtij ligji i fillon efektet respektivisht në të njëjtën kohë me afatet specifike të përcaktuara në ligjin për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit.

Të dyja janë korrekt, por ka vetëm një problem. Siç e thashë dhe dje, miratimi në parlament bëhet me datën 18, dhe këto hyjnë në datën 3. Problemet e efekteve financiare duhet t’i zgjidhim.

Kush ka sugjerim, le ta thotë. Apo do ta lëmë ashtu siç lamë ligjet e tjera, me Fletoren Zyrtare.

Arben Ahmetaj – Jo, vetëm me Fletoren Zyrtare.

Për tashti, si do ta bësh? Do ta bësh prapavepruese? Ku e ke parë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Anastas Angjeli – Atëherë mbetet kështu.

Arben Ahmetaj – Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Anastas Angjeli – Para se të kalojmë në votimin në tërësi, dje e lamë se do të bënim një ndryshim sa i përket pjesës së autobusëve me elektrikun, si dhe programin e rindërtimit.

Dëgjojmë propozimin, që ta votojmë.

Arben Ahmetaj – Për sa i përket autobusëve, mirëpres sugjerimin e Ministrisë së Financave, në mënyrë që komisioni të mos fusë duart në nivele, pa rënë dakord me ju.

Kësisoj, çfarëdolloj sugjerimi që të keni, qoftë edhe sugjerimin që të mos e ngacmojmë, do të konsiderohet.

E dyta, siç e thashë, unë kam propozuar ndryshime në ligjin e TVSH-së, ndryshime të cilat, në logjikën ligjore dhe në atë të teknikës fiskale, le të themi, do të jenë të përkohshme. Kanë të bëjnë me programin e rindërtimit dhe vetëm me programin e rindërtimit.

Fillimisht po shpreh logjikën time. Më pas do të lexoj se si ne, në mënyrë të përbashkët, kemi vendosur hartojmë nenin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, për TVSH-në po flasim.

Logjika është se vetëm projektet dhe vetëm subjektet që do të punojnë brenda programit të rindërtimit, të kenë përjashtim në import, qoftë të shtëpive të gatshme, qoftë të një liste të ngushtë, liste të kufizuar të materialeve të ndërtimit, e cila përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, materiale që do të përdoren për këtë program, me autorizim nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, me autorizim.

Së dyti, edhe ndërtimin e shtëpive ose banesave brenda projektit të rindërtimit, që e kaluam në parim në buxhet, ndërsa sot do ta kalojmë në detaje, pra sektorin e ndërtimit, do të jetë vetëm nga ato subjekte që do të merren me programin e rindërtimit, me projektet specifike të autorizuar nga qeveria, me autorizim të dhënë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, deri te volumet, në bazë të preventivave, gjë që mund të detajohet me vendim të Këshillit të Ministrave, t'i lehtësojmë

nga TVSH-ja. Kjo në mënyrë që, duke rindërtuar, të mos rrisim koston momentale, aq më tepër që akoma nuk e dimë se sa do të shkojë fatura e dëmeve.

Thënë këto, unë po e lexoj ashtu siç kemi rënë dakord bashkë. Gjithsesi, dua t'i lëmë hapësirë Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit të Financave, në lidhje me të gjitha rregullat për detyrimin për autorizime specifike, për listat e materialeve të ndërtimit, në lidhje me mënyrën si bëhet procedura e dhënies së autorizimit: pra, vjen projekti, vjen miratimi nga qeveria, nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, i cili mendohet e do të jetë autoriteti ekzekutiv i një pjese të programit; nga Ministria e Infrastrukturës, nga Ministria e Shëndetësisë apo nga një ministri tjetër. Pra, që ju ta keni këtë mundësi, që ta detajoni procedurën.

Unë po e lexoj:

Në neni 53 bëhen këto ndryshime: Në shkronjën 'g', pas fjalisë së parë, shtohet fjalia me këtë përmbajtje, por që gjithsesi, Shërbimet e Kuvendit, me Enkelejdën e me Nikon, zëvendësministrin, ta detajojnë me po këtë kujdes që unë i referohem, për të kufizuar përjashtimin për programin dhe subjektet. Asnjë milimetër jashtë kësaj.

Pas fjalisë së parë, shtohet fjalia me këtë përmbajtje: "Përjashtimisht nga përcaktimet e kësaj pike, është furnizim i përjashtuar nga TVSH-ja furnizimi i procesit të ndërtimit nga ndërtuesit e autorizuar nga Këshilli i Ministrave".

Nuk ka komitet që mund të përzihet me ekzekutimin. Pra, fjala 'komitet' nuk ekziston.

Pra, autorizohen nga Këshilli i Ministrave, nga Ministria e Financave ose nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, mos dilni jashtë kornizës zyrtare.

Për rastet e shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore gjatë periudhës së rindërtimit, të përcaktuar si të tillë nga legjislacioni i posaçëm për rindërtimin. Këtë e dua një çikë më të qartë. Punoni një çikë, Enkelejda dhe Ervina.

Pra, hiqet komiteti dhe lihet ose Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ose Ministria e Financave. Unë do të preferoja të ishte Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Ose ndoshta edhe Këshilli i Ministrave, por Këshilli i Ministrave nuk jep autorizim. Autorizim jep Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Dhe e doganave, në rastin e importit.

Dakord, Niko?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti zëvendësministër, po të punoja për ty, dhe do të punoja me kënaqësi, sepse...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një sekondë, sapo të mbaroj, se po flas.

Po të punoja për ty, do të punoja me kënaqësi, se je djalë i zoti, do të thosha: Këshilli i Ministrave përcakton gjithë procedurën, që do të thotë se Këshilli i Ministrave do të nxjerrë një VKM, ku do të thotë: kur të vejë firma X tek tatimet, që të aplikojë për përjashtim, tatimet do t'i kërkojnë lejen e ndërtimit, letrën e konfirmimit nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit ose nga ministria, volumet, lëndën e parë që do të importojë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vi ta shkruaj unë, mos u bëj merak, sinqerisht! Unë i lirë jam gjithë ditën, kështu që vij e ta shkruaj, të premtoj për këtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, se kemi tjetrën.

Pas shkronjës 'k' shtohet edhe shkronja 'i', me këtë përmbajtje: "Furnizimi i shërbimeve dhe mallrave, i kryer direkt për ndërtuesit e autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, si subjekte të rindërtimit, brenda programit të rindërtimit – do t'i referoheni, sepse është program më vete në buxhetin e shtetit – që përdoren prej tyre në procesin e ndërtimit, për rastet e shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme përgjatë periudhës së rindërtimit, të përcaktuar si të tillë nga legjislacioni i posaçëm për rindërtim, përjashtimi nga TVSH-të duhet të reflektohet në çmimin e shitjes së këtyre mallrave dhe shërbimeve, furnizimeve, të cilat duhet të jenë të dukshme, me çmimet më të ulëta se furnizimi... ”

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do ta them unë se kush do ta bëjë. Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ja ta lexojmë deri në fund, se jua shpjegoj:

“...dukshëm me çmime më të ulëta se furnizimet e ngjashme për raste të tjera jo për qëllime të fatkeqësisë natyrore. Asnjë përjashtim nuk akordohet për furnizuesit e mallrave ose të shërbimeve, që nuk furnizojnë direkt ndërtuesin e autorizuar.”

Për të sqaruar komisionin, në bazë të nenit që po draftojmë, që do ta diskutojmë më vonë, me buxhetin, Këshilli i Ministrave autorizohet me ligj, që të përcaktojë institucionet ekzekutuese, me vendim të Këshillit të Ministrave, të cilat mund të jenë: një bashki, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, një ministri, Autoriteti i Rrugëve.

Pra, i gjithë diskutimi është që çdo gjë mbetet brenda kuadrit të Këshillit të Ministrave dhe institucioneve specifike shtetërore.

Këtu, në këtë ndryshim që unë po propozoj, futen natyrshëm edhe dy-tre fondacione, të cilat mund të ndërtojnë, që do të autorizohen po ashtu si fondacione, si dhe kompanitë që do të punojnë për të ndërtuar ato objekte ose ato banesa që do të vendosin të bëjnë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ja, të mbaroj, dhe patjetër, nuk diskutohet.

Është shumë e rëndësishme, sepse do të duhet të lehtësojmë punën për rindërtimin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ministria e Arsimit....

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Brenda të njëjtit program. Do t’jua lexoj nenin pastaj. Kemi hartuar një nen shumë të mirë, që i jep mundësi Këshillit të Ministrave të jetë i shpejtë dhe fleksibël me institucionet e veta.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ia lëmë Këshillit të Ministrave. Këshilli i Ministrave mund t’i japë një projekt bashkisë, pesë projekte Fondit Shqiptar të Zhvillimit, dy projekte...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, do ta shikoni se është vërtet i qartë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do t’ju lutesha për pak qetësi.

Niko, e keni kohën për t’i sqaruar.

Në pikën 28 të nenit 56, pjesa e dytë e fjalisë, pas presjes, ndryshon me përmbajtjen si më poshtë: “përgjashtuar materialet, pajisjet, ndërtesat e parafabrikuara, të importuara...”

Jo vetëm të parafabrikuara, Niko, se mund të jetë një formë tjetër. Nuk e di tashti, se nuk e njohim komplet teknologjinë.

“...të importuara për këtë qëllim nga organet shtetërore, organizatat bamirëse dhe filantropike, për rastet e shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, sipas afatit të përcaktuar me autorizim, të lëshuar nga institucioni”.

Komiteti nuk ekziston. Komiteti është koordinativ, nuk ka asnjë fuqi ekzekutive, por është koordinativo-konsultativ, le të themi. Kështu që, komiteti hiqet nga neni.

Me ato definime të vogla që përmendëm, kush është pro, që ta shtojmë në rakord me Ministrinë e Financave? Kundër?

Faleminderit, që votoni pro!

Abstenim?

Miratohet!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kishit ndonjë propozim?

(Ndërprerje incizimi)

Çfarë mendimi keni për autobusët e transportit publik?

Elton Haxhi – Tani, për autobusët, direktiva parashikon jo më pak se 5 % normë të reduktuar të TVSH-së. Ne e kemi 6 %, dhe 6-ën nuk e kemi vetëm për këta, por e kemi nivel pak a shumë të unifikuar për të gjithë sektorët ku kemi dhënë një nivel të reduktuar të TVSH-së. Thënë kjo, nuk mendojmë se mund të shkojmë më poshtë se 6. I mbetemi ndryshimit të fundit ligjor, që është bërë vitin e kaluar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Po, ju lutem!

Blerina Gjylameti – Faleminderit, kryetar!

Edhe vjet, në ndryshimin që është bërë në reduktimin e TVSH-së për autobusët elektrikë, kërkesa ka qenë që të ishte zero. Atëherë diskutuam së bashku, që të ishte 6, si fillim, për të parë si do të ishte kërkesa, si do të aplikohet dhe si do të ndryshojë. Kërkesa vazhdon të jetë përsëri në zero, sepse, teksa lehtësojmë apo përjashtojmë nga TVSH-ja makinat elektrike, për shkak të ndikimit që do të kenë në mjedis, imagjinoni ndikimin që kanë autobusët e transportit publik.

Kështu, unë mendoj se do të an duhet të gjejmë një mënyrë për të kaluar në reduktim. Ndoshta jo në përjashtim, sepse përjashtimi mund të na sjellë problematika të tjera, jo neve, por kompanive, por besoj se një reduktim duhet bërë, sidomos në qytetet e mëdha, ku kërkesa është shumë e madhe, por edhe ndotja është e lartë, për shkak të trafikut dhe përdorimit të mjeteve. Besoj se kjo do të ishte zgjidhja e duhur. Më shumë se sa të investojmë më pas në rikuperim të dëmeve, ne duhet t'i parandalojmë ato.

Besoj se kjo nxitje ndihmon dhe i kthen përgjigje kërkesave të tyre të vazhdueshme. Kanë qenë edhe vjet këto kërkesa, edhe pse ne arritëm në 6 vjet, vazhdojnë të jenë edhe sivjet. Mendoj se duhet të shikojmë mënyrën se si ta reduktojmë ende, ku, jo vetëm për privatët që duan të blejnë

një makinë elektrike, por në mënyrë të posaçme për transportin publik ne të kemi nxitje për të arritur të kalojmë në të gjitha flotat e autobusëve të transportit publik në autobusë elektrikë.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Përrjashtimi do të sillte problematikë në kreditim dhe rimbursimi, pra përrjashtimi, do të ishte në dëm të tyre.

Mendoj të ecim me propozimin e zotit Angjeli, por dua që të jemi në rakord me ju, pa cenuar sistemin, që të reduktohem akoma më shumë.

Anastas Angjeli – Ne e kemi 6% deri në fund të vitit 2020, pra e kemi bërë një herë dhe deri në fund të vitit 2021, 10%. Në qoftë se do të merrni variantin e reduktimit, mund të bëjmë përrgjysmimin e këtyre në këtë dy vjet, 3% dhe 5%, sepse 0% nuk e bëjmë dot, as përrjashtim nuk e bëjmë dot.

Arben Ahmetaj – Komisioni ka rënë dakord që ta debatojë me qetësi me ju, madje edhe opozita besoj se bie dakord me logjikën time dhe të maxhorancës.

Ne nuk duam të bëjmë një gjë që do t’ju prishë sistemin. Jemi shumë të ndjeshëm ndaj asaj, kështu që na thoni me qetësi shqetësimin dhe, nëse keni rrugëdalje, na e thoni edhe rrugëdaljen.

Elton Haxhi – Sipas direktivës lejohen vetëm dy norma të reduktuara. Ne kemi 6-ën dhe 10-ën. Pra, dy norma të reduktuara i kemi dhënë. Nën 5% nuk është e pranueshme, pra 5-a është kufiri minimal, kurse ne jemi te 6-a. Ajo çka mund të bëjmë është të ruajmë 6-ën.

(Diskutime pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Më falni! Kam një sugjerim miqësor: nuk thuhet në komision që na ngelet 6-a e turizmit, thuhet ndryshe, thuhet na prishet formati i niveleve.

Na e argumento tamam, të lutem!

Anastas Angjeli – Në vazhdim të propozimit, që të mos preket asnjë nga ato, i bëjmë të dyja 6, 2020-ën dhe 2021-shin.

(Diskutime pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Pra, kjo është rrugëdalja.

A jeni dakord me këtë logjikë?

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

E votojmë në tërësi projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar””.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Faleminderit!

Para se të kalojmë te ligji i të ardhurave do të diskutojmë edhe një çështje që kemi lënë pa e mbyllur te ligji i procedurave, që ka të bëjë me netimin. Do ta risjellim në fund fare.

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë më, 13.12.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi nen per nen i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”
2. Shqyrtimi nen per nen i projektligjit “Per Buxhetin e vitit 2020”

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Arben Elezi, Evis Kushi, Anastas Angjeli, Suzana Topi,
Reme Lala, Ervin Bushati, Blerina Gjylameti, , Xhavit Bushaj, Roland Xhelilaj, Senida Mesi, Vullnet Sinaj, Eljo Hysko, Edlira Hyseni, Artur Roshi, Krenar Ryçi, Korab Lita, Ylli Shehu.

Mungojnë:

Antoneta Dhima,

Te ftuar

Ministria e Financave dhe Ekonomise

1. Zv/Ministri Z. Elton Haxhi
2. Z. Nikolla Lera Drejtor I Pergjithshem
3. Znj. Mimoza Dhembli Drejtoreshe e Pergjithshme e Buxhetit,
4. Znj. Suzana Stefa Drejtoreshe e Investimeve Publike,
5. Z. Gentian Opre Drejtor I Analizës dhe Programimit Buxhetor,
6. Z. Fran Brahimi Drejtor i Financave Vendore,
7. Znj. Ina Dhaskali P/sektori tek Programimi Buxhetor,
8. Znj. Vilma Causholli P/sektori tek Analiza Buxhetore.
9. Enkeleda Pipa
10. Enkeleda Kuci
11. Dorjana Toro
12. Ilir Sallaku

Arben Ahmetaj – Fillojmë diskutimin e ligjit “Për të ardhurat”.

Anastas Angjeli – Para se të fillojmë me nenin 1, dua t’ju kujtoj se ne patëm një diskutim kur diskutuam në parim për mënyrën se si tatohet, kur pasuria, prona, veçanërisht kur është fjala për banesat, kalon për trashëgimi dhe a duhet të taksohet apo jo.

Evisi ka një propozim. Le ta dëgjojmë!

Evis Kushi - Faleminderit!

Së bashku me kolegun Vorpsi, kemi prezantuar një amendament në komision, sipas të cilit përjashtohen nga detyrimi i pagesës së tatimit mbi të ardhurat prej 15% në të gjithë ato raste të kalimit të së drejtës së pronësisë për banesë apo truall, nëpërmjet dhurimit brenda trashëgimtarëve të nivelit të parë, kur vlera kadastrale është deri në 30 milionë lekë të reja.

Më lejoni ta specifikoj! Ne propozojmë që të hiqet tatimi mbi të ardhurat prej 15% kur bëhet kalimi i pronësisë nga prindi te fëmija apo nga bashkëshorti te bashkëshortja (jo në rastet kur kalon nga vëllai te motra apo te kushëriri e kështu me radhë).

E dyta, e kemi bërë këtë propozim vetëm për banesën e parë, sepse mund të jetë një pronar pallati, një ndërtues që mund të ketë 10 banesa që ua dhuron fëmijëve. Në këto raste jo. Ne kemi parashikuar vetëm për banesën e parë.

Së treti, ne e kemi bërë këtë përjashtim vetëm për rastet e banesës dhe të truallit, jo për rastet kur kanë dyqane apo prona.

Në rastet ku ka një pronë që është burim të ardhurash, atëherë ka një logjikë që të japësh një kontribut në buxhetin e shtetit. Propozimi ynë është vetëm për t’i ardhur në ndihmë familjeve, për t’i zgjidhur këto marrëdhënie.

Së fundi, në propozimin tone kemi vënë një kufizim, kur vlera e banesës shkon deri në 30 milionë lekë të reja. Këtë ne mund ta diskutojmë. Nëse vlera kadastrale do të jetë mbi këtë vlerë, ne kemi parashikuar që kontributi ose detyrimi për pagesën të jetë 3% për vlerën mbi 30 milionë.

Këto janë katër specifikimet e amendimit tonë.

Po ju them argumentet pse e kemi sjellë këtë amendament.

Së pari, kemi pasur shumë shqetësime nga qytetarët, të cilët shpeshherë kanë problematika sociale në familje.

Edhe nga komunikimet që kemi bërë me zyrat kadastrale, kontributi në buxhet është pothuajse zero, se pothuajse nuk bëhen fare, sepse duke qenë se tatimi është 15%, imagjinoni për

një banesë që kushton 50 milionë lekë, për t'ia dhuruar babai fëmijës, detyrimi është 7,5 milionë, pra një detyrim shumë i lartë për një familje me të ardhura mesatare, sepse ju e vini re se qëllimi ynë është për familjet e thjeshta, jo për shtresat e larta.

15%-shi që është aktualisht në ligj është frenues, është pengues dhe pothuajse nuk bëhen fare dhe nuk rregullohen këto marrëdhënie.

Qëllimi ynë është që, për sa kohë prindërit janë gjallë, të rregullohen dhe të nxisin një vëllazëri të mirë, një bashkëjetesë të mirë brenda familjeve.

U jemi referuar edhe shteteve të tjera në rajon dhe në BE, për shembull, i jemi referuar rastit të Italisë, ata kanë vendosur një kufi prej 2 milionë eurosh (atje ka tjetër standard jetese). Ne mund ta diskutojmë me kolegët shifrën që kemi menduar.

Propozimi është në të njëjtën frymë edhe me tokën bujqësore. Pra, aktualisht në ligj, kur bëhet kalimi i pronësisë mbi tokën bujqësore, nuk paguhet tatim mbi të ardhurat. Kjo, madje, duhej të ishte hapi i dytë, hapi i parë duhej të ishte banesa, se në fund të fundit toka bujqësore sjell edhe përfitime, sjell edhe të ardhura.

Këto janë argumentet që kemi paraqitur ne.

Arben Ahmetaj – Do të bëj një koment për të hapur diskutimet.

Ka qenë një problem i vazhdueshëm dhe do të duhet të korrigjojmë. Le të biem dakord të kufizohemi te banesat (vetëm për një banesë). Ta konsultojmë me Ministrinë e Financave, në mënyrë që ta kemi të qartë procedurën. Pra, bëhet një banesë për familje, e dyta është trualli dhe e treta toka bujqësore dhe asnjë objekt komercial. Çdo gjë që siguron të ardhura përveç truallit. Trualli mund të çlirojë edhe transaksione të mëtejshme, sepse secili merr pronën e vet.

Urdhëroni, zoti Roshi!

Artur Roshi - Faleminderit!

Unë jam i mendimit për ta plotësuar dhe për mos ta kufizuar vetëm te një banesë dhe tek trualli, por për ta shtrirë në çdo lloj pasurie që kanë prindërit tanë dhe duan t'ua dhurojnë fëmijëve. Nuk duhet të ketë limit.

Në qoftë se niseni nga fakti se ambientet e tjera që janë komerciale, pra që shteti ka përfitime, unë mendoj që nuk duhet të përfitojë këtu, nuk është ky vendi për të përfituar. Vendi për të përfituar është taksa mbi pronën dhe taksa mbi biznesin që do të bëjnë i biri, nipi e me radhë. Koncepti mbi pronën është ky. Nuk kemi pse themi që nga babai tek i biri, duhet të marrim një taksë ekstra për të ruajtur logjikën. Duhet të kemi parasysh se vendi ynë nuk do të rrijë gjithmonë

në këtë varfëri dhe këto ligje nuk mund të bëhen dhe të ndryshojnë përditë. Me këtë koncept, mendoj se ne do të demoralizojmë të pasurit, që të ndjekin instinktin e fitimit në pronat e tyre, dhe ato do të kthehen në pasivë për t'i shpërdoruar keq këto para nëpër kazino apo për të bërë shpenzime të shfrenuara, sepse ata nuk kanë interes që këtë pronë ta posedojë i biri nesër, duke ia tatuar ne. Prandaj ne nuk duhet t'i ngarkojmë dhe unë mendoj se duhet të marrim SHBA-në si shembull.

Propozimi im është që të jetë pa limit, jo vetëm për apartamentin, por për cdo lloj pasurie që ka i ati, për ta trashëguar tek i biri.

Arben Ahmetaj – Nëse i referohemi SHBA-së, atje ka diskutime që trashëgimia të tatohet 90%, pra është e kundërta.

Sugjerimi im është që 30-milionëshin ta heqim, se i bie të bëhen dy ndarje, përderisa kemi kufizuar shtëpinë dhe truallin. Megjithatë, ne duhet të dëgjojmë Ministrinë e Financave.

Propozimi juaj do të hidhet në votë në bazë të procedurës.

Urdhëroni, zoti Lita!

Korab Lita – Unë nuk kam propozim konkret, vetëm sqarim. Sa i takon linjës së dhurimit, ju thatë nga babai te fëmija. Po fëmija a s'ka të drejtë t'i dhurojë babait?

Arben Ahmetaj – Kjo nuk është trashëgimi, por është dhurim.

(Diskutime pa mikrofon)

Urdhëroni, zonja Kushi!

Evis Kushi – Kur e hartuam amendamentin, jo vetëm që u konsultuam me legjislacionin e vendeve të tjera, e menduam shumë edhe propozimin e zotit Roshi dhe do të ishte shumë mirë, nuk diskohet, a ka mundësi të mos kenë taksa fare qytetarët, por ne duhet të mendojmë edhe për buxhetin e shtetit.

Ne e kemi menduar gjatë këtë, por nuk mund t'i shikojmë nga këndvështrimi i qytetarëve. Natyrisht, do të ishte shumë mirë, por edhe buxheti i shtetit i qytetarëve është. Kjo është ideja.

Arben Ahmetaj - Një sekondë!

Çfarë mendimi ka Enkelejda?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mos u mërzit se këtu jemi.

Enkeleda Pipa - Referuar propozimit që u bë është e rëndësishme të jetë i qartë propozimi që bëri zonja Kushi, sepse u përmendën dy terma, trashëgimi dhe dhurim. Trashëgimia është një koncept shumë i ndryshëm nga dhurimi. Duhet të jemi të qartë nëse bëhet fjalë...

Arben Ahmetaj - Zonjë këtë e thashë unë, mendova se keni ndonjë gjë tjetër.

Faleminderit!

Enkeleda Pipa - Trashëgimia lind vetëm pas vdekjes...

Arben Ahmetaj - Faleminderit!

Bëhet fjalë për problematika korrente...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonjë, nuk të kam dhënë leje.

Është dhurim në linjë trashëgimie.

Zonja, a mund të largoheni nga mikrofoni dhe të dilni mbrapa?

Faleminderit!

Logjika e deputetes është në linjë trashëgimie, jo nga poshtë lartë, por nga lartë poshtë: nga babai, nga gjyshi në linjë trashëgimie. Ky është koncepti i trashëgimisë jo *perse* fiskale. Niko, çfarë mendimi ke?

Nikolla Lera – Ne jemi njohur me propozimin e zonjës Kushi. Ne u kemi ofruar dhuruesve, prindërve për fëmijët edhe një mekanizëm tjetër rivlerësimi. Kushdo qoftë edhe rastet që duhet të adresohen me këtë amendim kanë të drejtën të rivlerësojnë pasurinë në mënyrë që tatimi mbi të ardhurat personale nga kalimi i të drejtës së pronësisë nëpërmjet dhurimit 15 % të mos cenojë të ardhurat e pa mbledhura, sepse është dhurim i prindit. Këtë e thashë, se kemi një mekanizëm tjetër për të zbutur këtë fenomen. Ne nuk jemi kundër. Mund të vendosim një klauzolë për përjashtimin nga tatimi në rastet e dhurimit brenda familjes të kufizuar në propozimin e deputetes. Mendojmë të mos ketë një prag aq të lartë 30 milionë: duhet ose ta kemi pa prag ose të caktojmë një prag më të ulët, sepse bëhet fjalë për dhënien e një shtëpie ose të një pjese të truallit dhe vlera 30 milionë është e lartë.

Në fund dua të theksoj se lidhur me dhurimet dhe me trashëgimitë ne nuk e kemi të zhvilluar legjislacionin fiskal, trashëgimitë i kemi totalisht jashtë sistemit fiskal. Dhurimet i trajtojmë si kalim pronësie dhe i taksojmë, ndërkohë që në vendet e tjera janë në legjislacione të miratuara subjekt i tarifave tatimore të larta, por ne nuk e kemi të zhvilluar këtë pjesë të legjislacionit për të taksuar.

Arben Ahmetaj – Pra, ajo që propozon zonja Kushi, ka të bëjë me dhurimin në linjë trashëgimie, as trashëgimi *perse* fiskale dhe as dhurim i pastër. Jemi duke folur për një moment në jetën e Shqipërisë, ku çfarë ekziston: shtëpi dhe truall të degëzohen pa taksë të lartë.

Zonja Kushi iu referuar 3%-shit në mënyrë që të kemi një hap tek i gjithë legjislacioni fiskal i trashëgimisë.

Për mua duhet të hiqet pragu. Nuk duhet të ketë prag, sepse pastaj krijojmë dy nivele që janë të gabuara. Megjithatë të dëgjojmë zonjën Gjylameti. Më pas zotin Roshi. Pastaj të bëjmë një kombinim midis jush dhe shërbimit të Kuvendit për të hartuar një nen ose dy nene në bazë të propozimit që t'i referohen problematikës dhe zgjidhjes së saj. Mua më pëlqen logjika me rivlerësimin, më pëlqen shumë, sepse nuk e prek sistemin, u krijon një mundësi që të bëjnë transaksione. Nuk e prishim logjikën e transaksionit, të taksës. E zgjidhim problemin. Kjo është një gjë që ne mund ta konsiderojmë pas pyetjeve apo komenteve që do të kenë zonja Gjylameti dhe zoti Roshi.

Blerina Gjylameti – Faleminderit, zoti kryetar!

Duke mbështetur propozimin që ka bërë zonja Kushi me zotin Vorpsi, mendoj se duhet të kemi edhe një shtesë në atë propozim, sepse nëse marrim rastin e dy prindërve që u dhurojnë shtëpinë 2-3 fëmijëve, fëmijët midis tyre vendosin që ta marrë njëri, atëherë çfarë do të bëjmë: tatim mbi të ardhurat te një fëmijë? Në këtë pjesë, është kjo, por krijon shumë probleme. Ka vite në Shqipëri që kemi problematika të tilla ndërmjet trashëgimtarëve të rangut të parë. E njëjta shtëpi, kur vdesin prindërit u quhet tatim mbi të ardhurat nëse dy vëllezër ia lënë motrës apo motra ia lë vëllait. Në këtë rast duhet të kemi të njëjtin trajtim, kur është rasti i tillë, flas për një shtëpi apo për truall, jo në pjesën kur të gjitha pronat që kalojnë mund të jenë burim të ardhurash, por flasim vetëm për këtë rast. Do të doja ta shikojmë këtë gjë, sesi mund të ketë të njëjtin trajtim.

Arben Ahmetaj - Po, zoti Roshi.

Artur Roshi - Do të isha kurioz se çfarë mendon zëvendësministri apo përfaqësuesit e qeverisë...

Arben Ahmetaj – Për procedurë, jo për kuriozitet...

Artur Roshi – E di se çfarë përgjigje do të japin, por po e bëj pyetjen: cili është mendimi juaj në lidhje me propozimin që bëra?

Elton Haxhi - Mendimi ynë si ministri është se duhet të përkufizohen mirë termat dhe cili është subjekt i këtij lehtësimi fiskal, në mënyrë që të mos ketë abuzime në transferime apo në dhurime që nuk janë brenda trungut që sapo u fol.

Nga ana tjetër edhe niveli i transferimit duhet të rishikohet pasi efektet fiskale mund të jenë të rëndësishme. Lehtësinë që dhamë për rivlerësimin në gjykimin tonë, të paktën në një kohë afatshkurtër, e kemi zgjidhur këtë çështje me mundësinë e rivlerësimit të pasurive dhe nuk kemi pse e japim këtë si incentivë. Në terma afatgjatë, jam dakord që duhet të bëhet një lehtësim i tillë, por duhet pasur kujdes me kufizimin vetëm në ato raste që kanë sens familjar dhe nuk përbëjnë një transferim të aktivitetit ekonomik apo transferim të pasurive, të cilat janë pjesë dhe subjekt i tatimit.

Arben Ahmetaj – Po, zoti Roshi.

Artur Roshi – Ju jeni vetëm për shtëpinë dhe truallin apo për çdo lloj prone që posedon i ati për t'ia dhënë të birit apo dhe për çdo lloj trashëgimtari tjetër? Mund të kemi një rast të tillë: një çift i suksesshëm në biznes ka një fabrikë dhe nuk ka fëmijë, ata kanë të drejtë që këtë pasuri t'ia lënë trashëgimi kujt të duan, por përtej kësaj se ky mund të jetë një rast specifik, ku çdo pasuri që unë posedoj kam nesër të drejtë t'ia lë trashëgimi të gjitha. Pra, ju jeni dakord vetëm për shtëpinë apo për të gjitha pasuritë që posedon X person?

Arben Ahmetaj - Do t'ju tërheq vëmendjen edhe miqësisht, por edhe zyrtarisht, nuk duhet të marrë fjalën pa leje asnjëri nga ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E kam me zotin Angjeli.

Kur flet dikush nga deputetët ose përfaqësuesi i qeverisë ta dëgjojmë për të marrë vesh se çfarë thuhet.

Elton Haxhi – Trashëgimia është e përjashtuar në rastet kur dikush ndërron jetë. Në rastet e tjera që përmendët është transferim i një aktiviteti ekonomik dhe është subjekt i parashikimeve që ka legjislacioni fiskal.

Arben Ahmetaj - Po, zoti Angjeli.

Anastas Angjeli - E para, u futëm në një diskutim midis trashëgimisë që nuk ka lidhje fare me propozimin e zonjës Kushi dhe kalimin e pronës brenda trungut të trashëgimisë, sepse trashëgimia këtu nuk është koncept juridik për të bërë një diskutim dhe një debat. U zgjatëm 40 minuta, por nuk kemi faj asnjëri as tjetri, sepse kështu e kemi informacionin.

Unë mendoj që propozimi i zonjës Kushi të mos i kapërcejë sot në këtë fazë kufijtë e dy propozimeve të dy pikave të para, se do të hyjmë në një qorrsokak që nuk do të dalim dot. Me sqarimet që dha ministria për transferimin e pronës, të rivlerësimit dhe të legjislacionit për trashëgiminë të mbetemi vetëm te dy propozimet e para: tek i banesës dhe i truallit.

Arben Ahmetaj - Dhe do të heqim tavanin.

Anastas Angjeli - Po dhe ta mbyllim këtë çështje. Të lëmë ekspertët të bëjnë riformulimin sipas propozimit dhe rregullimeve që bëjnë. Në të ardhmen jemi të hapur për një kuadër të përgjithshëm.

Arben Ahmetaj - Kush është pro propozimit të zonjës Kushi me kusht që të hiqet referenca e vlerës si kufi? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Anastas Angjeli - Neni 1 i ligjit me shtesën, me propozimin e fundit të votuar duhet të votohet edhe një herë.

Arben Ahmetaj – Votojmë nenin 1 me ndryshimet që votuam në referencë të propozimit të zonjës Kushi dhe me komentet shoqëruar për limitin. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2.

Anastas Angjeli – Nëse stafi i Kuvendit e gjykon që për procedurë legislative ndryshimet e propozuara të jenë nen më vete, mund të jenë nen më vete dhe renditjen e bëjnë ata.

Neni 2 i projektligjit ka një ndryshim të vogël, që i referohet harmonizimit të këtij ligji me ligjin e fiskalizimit. Referencat ligjore si të ligji “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, duhet të bëhen siç vepruam edhe në ligjet e tjera: “Legjislacionin në fuqi “Për faturën dhe sistemin e monitorimit dhe të qarkullimit”.

Arben Ahmetaj - Kush është pro me komentin ndryshues të zotit Angjeli? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 3.

Anastas Angjeli – Neni 3 mbetet siç është, nuk ka vërejtje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj - Për këtë nen propozimi im është që me të njëjtën logjikë për sportet, të fusim si shpenzime të zbritshme dhe ta hartojmë së bashku klauzolën për të gjitha kompanitë që shpenzojnë për të ekspozuar mallrat e tyre, që janë kompani eksportuese në ekspozitat ndërkombëtare me autorizim të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Janë kompani që eksportojnë, nuk u njihen si shpenzime të zbritshme, t'u njihet 1x 2. Çfarë mendimi keni? Cili është qëllimi mbrapa këtij propozimi? Është që t'i promovojmë, t'i nxisim kompanitë tona eksportuese, aq më tepër që ky vit ishte i vështirë për eksportin, kemi rënie eksporti gati minus 3% dhe duhet të mendojmë tani.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo nuk ishin minerale, ishin kryesisht manifaktura dhe energji.

Niko Lera – Në fakt, bazuar në legjislacionin tatimor këto shpenzime konsiderohen si shpenzime përfaqësimi, që përfaqësojnë kompaninë në panaire, në tregje të huaja e të tjera dhe ne kemi një kufizim në ligj, që i kemi deri në 0,3% të qarkullimit vjetor...

Arben Ahmetaj- Mos më trego legjislacionin: 28 dhjetor i vitit 1998. Këtë ligj e kemi bërë bashkë, kur ishim të rinj.

Unë po bëj propozim, po të them gjë tjetër: shpenzim i njohur 1x2 më vete. Po më lexon ligjin që kam bërë vetë?! E mban mend se çfarë ka qenë? 28 dhjetor, e martë.

Niko Lera - Do të jetë më mirë që të rrisim nivelin e njohjes në këtë pikë, nga 0,3 në...

Arben Ahmetaj- Kush është pro propozimit që bëra për njohjen e shpenzimeve të marrjes pjesë në ekspozita dhe panaire për kompanitë eksportuese me autorizim të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve? Dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

0,3 % nuk ndryshon. Do të konsiderohet më vete, do të shkëputet.

Po e definoj: “Për pjesëmarrjen në panaire dhe në ekspozita në funksion të zgjerimit të tregut global për kompanitë shqiptare”.

Niko, t'ua lehtësojmë jetën juve dhe kompanive t'ua shtrëngojmë. Kjo është logjika që na thoni.

Jeni dakord me ndryshimin? Kush është pro me nenin 3? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 4.

Anastas Angjeli – Neni 4 ka 2-3 ndryshime të karakterit më tepër të teknikës legislative. Në fillim të pikës 1/1 të shtohen fjalët: “Përjashtimisht përcaktimeve të pikës 1 të këtij neni”.

Për sa i përket pikës 2 fjalët: “Paragrafi i mësipërm” të zëvendësohen me fjalët: “Pika 1 e këtij neni”. Këto të dyja duhet të rregullohen.

Neni 4, pikat 1 dhe 2 formulohen në këtë mënyrë:

1. “Pas pikës 1 të nenit 27 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje: “Përjashtimisht përcaktimeve të pikës 1 të këtij neni për tatimpaguesit, të cilët investojnë në projekte biznesi me vlerë mbi 1 miliardë lekë, në rast se fitimi i tatueshëm në një periudhë tatimore rezulton negativ, humbjet e rezultuara mund të mbulohen me fitimet në 5 vjetët në periudhat e ardhshme tatimore sipas parimit: humbja e parë, më përpara se ajo e fundit. Ministri përgjegjës për Financat përcakton me udhëzim kriteret dhe procedurat për zbatimin e kësaj pike”.

2. Në pikën 2 fjalët: “Paragrafi i mësipërm”, zëvendësohet me fjalët: “Pika 1 e këtij neni”.

Arben Ahmetaj – Po, zonja Gjylameti.

Blerina Gjylameti – Unë kam një sugjerim, të mos e lëmë thjesht të investojmë në “projekte biznesi”, por në “projekte strategjike”. Pra, të jenë në pjesën e projekteve apo investimeve strategjike të qeverisë, pasi gjithkush mund të investojë në ide biznesi, të cilat mund të mos jenë fitimprurëse dhe nuk ka pse ta mbajë barrën pjesa e institucioneve. Nëse janë në pjesën e investimeve strategjike të miratuara nga qeveria, patjetër që po. Sugjeroj të shtojmë: “Në investime strategjike”.

Arben Ahmetaj - Më lenoni të bëj një pyetje: cila është arsyeja që e keni sjellë këtë? Praktikisht ju po lejoni 5 vjet *carry over* të humbjeve.

Elton Haxhi- Arsyeja është që investimet në këtë vlerë kërkojnë kohë, e cila mund të shkojë nga 1-2 vjet, që do të thotë se pa mbaruar ende investimin dhe pa filluar të gjenerojë të ardhura i ka skaduar viti i parë i mbartjes së humbjeve. Thënë kjo, kemi menduar se duhet shtyrë në 5 vjet për t’i dhënë kohë të rikuperojë humbjet e viteve të para, në të cilat nuk ka pasur aktivitet.

Arben Ahmetaj – Dakord, për ta thënë më thjesht, kjo bëhet për të ndihmuar investimet vendase ose të huaja, të cilat duan një kohë më të gjatë për kthimin e investimit. Shumë saktë. A keni ndonjë statistikë që i keni shërbyer logjikës suaj?

Elton Haxhi – Kemi eksperiencën të rajonit.

Arben Ahmetaj – Jo, statistikë nga vendi.

Elton Haxhi – Statistikë se sa janë me humbje?

Arben Ahmetaj – Konkretisht a ka ndonjë problem në ndonjë sektor, apo grup biznesesh që e keni hasur?

Elton Haxhi – Kjo ka vite që kërkohet nga grupet e biznesit, nga shoqatat e investitorëve dhe nuk është adresuar më parë, prandaj u mendua të adresohet. Eksperiencat e vendeve të tjera e kanë 5 vjet, pavarësisht investimit.

Arben Ahmetaj – Pra mund ta kishit çuar edhe 5 nga 3 vjet në standard.

Elton Haxhi – Do ta konsiderojmë edhe atë, por me strategjinë e re.

Arben Ahmetaj – Shumë mirë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë mendoj të ecim me logjikën e Ministrisë së Financave, por gjithsesi do ta hedhim në votë edhe propozimin tuaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk e kufizon, e zgjeron, sepse tek turizmi e kemi më pak, e kemi 800 milionë.

Po, zoti Roshi.

Artur Roshi – Zoti Zëvendësministër, ju flisni këtu për investime për projekte biznesi me vlerë mbi 1 miliardë lekë. Kujt i referoheni dhe pse të mos jetë më pak? Me çfarë logjike e keni vendosur këtë kufi? Pyes sepse, si pjesë e opozitës, mendoj se ju kujdeseni vetëm për oligarkët dhe keni parasysh 4 apo 5 vetë që arrijnë mbi këtë shifër.

Arben Ahmetaj – Nuk mundet do ta linte pa thënë zoti Roshi.

Ju lutem, zoti Toni, shkurt!

Elton Haxhi - Ne i jemi referuar legjislacionit për investime strategjike, por për investimet jo në turizëm kostoja shkon në 1 miliardë e 250 milionë, ose 10 milionë euro, pra jemi munduar të shkojmë afër vlerës, por jo duke e kushtëzuar me investime strategjike, as me ato jostrategjike, mjafton që të jenë në të njëjtën vlerë investimi që është parashikuar në atë legjislacion. Pra, nuk kemi pasur oligarkë.

Arben Ahmetaj – Faleminderit që sqaruat që nuk ka lidhje me oligarkët, të cilëve u referohet zoti Roshi!

Unë kam nxjerrë në një emision dy qeveritë se si kanë furnizuar kompanitë e mëdha me projekte publike dhe ishte 1 me 4, domethënë 1 njësi ka shpenzuar për kompanitë e mëdha qeveria “Rama” dhe 4 njësi qeveritë e mëparshme. Por kjo nuk ka rëndësi, se jemi në diskutimin nën për

nen, jo për debat. Unë mendoj se varianti i Ministrisë së Financave është i saktë dhe do të kërkoj aprovimin e komisionit që të votojmë atë variant.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, me ndryshimet e propozuara nga zoti Angjeli, se nuk na vë në vështirësi as te strategjiket.

Po.

Elton Haxhi – Dua të bëj një saktësim te rifrazimi. Në fakt, pas pikës 1 duhet dhe 1/1.

Arben Ahmetaj – Kush është dakord me pikën 5? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Anastas Angjeli – Neni 6 është hyrja në fuqi. Do të ndjekim të njëjtin variant që kemi ndjekur me ligjet e tjera, kështu që do të themi “Ky ligj hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare”. Përfundimisht, përcaktimet e pikës 1, të nenit 2 të këtij ligji, i fillojnë efektet respektivisht në të njëjtën kohë me afatet specifike të përcaktuara në ligjin “Për faturën dhe sistemin e monitorimit dhe të qarkullimit”.

Arben Ahmetaj – Zoti Zëvendësministër, i shkruan shërbimi i Kuvendit të gjitha ato që duhet t’i shkruanit ju.

Le të votojmë nenin e fundit, pastaj do të bëj një propozim brenda këtij ligji.

Kush është pro ndryshimeve që propozoi zoti Angjeli? Kundër? Nuk ka, Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Niko, dua të përmirësojmë konfuzionin që keni krijuar si administratë për investitorët e huaj te neni 23/1 i ligjit “Për të ardhurat”. Dua që në atë nen të shtohet fjalia, ne e kemi bërë një hartim të paragrafit, “përveç për vendet ku ka traktate të shmangies të tatimit të dyfishtë...”. Hajde ta gjejmë tamam fjalinë!

Cila është arsyeja? Ministria ka bërë një interpretim të gabuar, dhe ju e dini, ka nxjerrë ligjin vendas mbi traktatin dhe Kushtetutën, por ju doni siguri maksimale në jetët tuaja, ndërkohë që siguria iu është dhënë nëpërmjet Kushtetutës. Gjithsesi jam dakord ta shtojmë këtë fjali.

Niko, ma jep formulimin, që ta hedhim në votim!

Çfarë ka ndodhur? Praktikisht ne bëmë një ndryshim vitin e kaluar dhe vendosëm një kufi 50% kur ka *real estate* dhe zgjeruam të drejtën e administratës për të taksuar *capital gain* këtu nëpërmjet kompanisë si instrument për aksionerët që nuk janë këtu dhe kjo është logjika kur nuk

kemi marrëveshje të shmangies së tatimit të dyfishtë. Kemi punuar 3 veta në mënyrë të detajuar, pra unë, Niko dhe Ervini. Por siç ndodh Ministria e Financave bëri një interpretim që bie në kundërshtim me Kushtetutën, prandaj për të mos pasur konfuzion në të ardhmen do të shtojmë këtë fjali.

Niko, a mund ta thuash fjalinë që do të shtojmë aty?

Niko Lera – Në nenin 27/1 pas pikës 5 shtohet pika 6 me këtë përmbajtje: “Parashikimet e këtij neni zbatohen në çdo rast, përveç kur ndryshimi pronësisë u nënshtrohet dispozitave të marrëveshjeve për shmangien e tatimit të dyfishtë në fuqi”.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Ervina, merreni formulimin dhe shtojeni në numerizim në nene dhe e hedhim në votë me të gjitha këto ndryshime, duke përfshirë edhe këtë, në tërësi.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka, Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kemi votuar paketën fiskale në tërësi.

Ju falënderoj!

Siç ju thashë, kur të mbarojë buxheti, dua shkruarit e shkruarit në një seancë të mbyllur pa medie, që të shohim qartë se si shkruhen.

Faleminderit!

Bëjmë 5 minuta pushim!

Qetësohuni që të fillojmë me buxhetin e shtetit 2020.

Meqë jemi në fund mendoj që me aprovimin tuaj të kthej për votim vetëm një aspekt të *net*-imit që ka kërkuar Ministria e Financave pas sqarimeve që i kërkuam. Koncepti qëndron.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E kam fjalën për *net*-imin, nëse e mbani mend debatin. Pas sqarimit që bëri Ministria e Financave mendoj të mbështesim atë për konceptin e ri të *net*-imit. Ta votojmë nëse do të biem dakord, pra lejin *net*-imit mes taksave.

Ervina, bashkë me Nikon dhe Tonin ta rifusin...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ia lëmë administratës, se e kanë përgjegjësi ligjore. Po të doni ta dini, edhe kur jepet në direktivë logjika e kompensimit brenda grupit, prapë i lihet administratës rast pas rasti. Prandaj

edhe në rastin konkret do t'ia lëmë administratës. A jeni dakord ta përfshijmë të procedurat nenin që dje e lamë pa votuar?

Kush është pro? Kundër? Nuk ka, Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është pro për procedurat me këtë ndryshim? Kundër? Nuk ka, Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Ligjit të procedurave i shtohet edhe kjo dhe jeni në rregull.

Punoni me shërbimet e Kuvendit që të zbardhen! Do të zbardhen siç janë diskutuar dhe votuar këtu, pra për fiskalizimin, për procedurat, për taksat nacionale, për TVSH-në dhe për të ardhurat.

Shpërndajua deputetëve koston totale me e-mali!

(pas 5 minutave pushim)

I gjithë ky komunikim është në referencë të ligjit “Për rivlerësimin” që kaluam. Për rekord ne kemi aprovuar nenin 1 ku thuhet: “Afat i parashikuar për kryerjen e vlerësimit të pasurive të paluajtshme me vlerën e tregut rekomandohet të zgjatet dhe me një muaj, deri në 30 qershor 2020”, kjo duke marrë në konsideratë faktin që gjatë periudhës së verës kërkesat e individëve që kanë interes për rivlerësim, pësojnë një trend rritës. Kohëzgjatja e afatit pasqyrohet në nenin 4 të projektligjit.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka, Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Të vlerësohet mundësia e përfshirjes në fushën e zbatimit të këtij ligji edhe e personave juridikë me kusht respektimin e parashikimit të bërë nga neni 22 i ligjit nr. 8438 i vitit 1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar”, sipas të cilit, në rastin kur bëhet vlerësim i aktivëve të veprimtarisë nuk lejohet të llogaritet amortizimi për shumën e vlerësuar”.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka, Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Në lidhje me pikën 8 rekomandohet mundësia që norma e tatimi që parashikohet të paguhet për regjistrimin e rivlerësimit të ulet nga 3 në 2%. Por e këtë votuam për 2%.

Duke marrë në konsideratë nevojën për harmonizimin e këtij neni me parashikimet e Kodit Civil, neni 122 dhe vijues, por edhe në kërkesat e ligjit nr. 11120 të vitit 2018 “Për kadastrën” pas

rakordimit me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës rekomandohet që neni 2 të riformulohet si më poshtë:

Rivlerësimi i pasurive të paluajtshme në proces regjistrimi.

“Objekt i këtij ligji është edhe rivlerësimi i pasurive të paluajtshme, që janë në proces regjistrimi, duke përfshirë edhe pasuritë e legalizuara në përputhje me legjislacionin në fuqi. Procedurat e rivlerësimit dhe pagesës për rastet e parashikuara në këtë nen përcaktohen me VKM”.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka, Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Duke marrë në konsideratë statusin e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe kompetencat e saj të parashikuara në ligjin nr. 11120 të vitit 2018 “Për kadastrën”, rekomandohet që neni 3 të riformulohet si më poshtë:

Neni 3. Aktet nënligjore.

“Ngarkohet ministri përgjegjës për Financat dhe drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për nxjerrjen e udhëzimit të përbashkët për procedurat e zbatimit të këtij ligji dhe për përcaktimin e tarifës së kryerjes së shërbimeve të parashikuara në këtë ligj nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji”.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka, Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Edhe një herë në tërësi për efekt të rekordit po lexoj dispozitën pe nenit 3 para se votojmë: “Rivlerësimi i pasurive të paluajtshme për personat juridikë, të cilët kanë të regjistruar në pasqyrat e tyre financiare pasuri të paluajtshme me vlerë më të vogël se ajo e tregut, kanë të drejtë të bëjnë, brenda periudhës së zbatimit të këtij ligji, rivlerësimin me vlerën e tregut të këtyre pasurive. Rivlerësimi me vlerën e tregut bëhet nga ekspertë të pavarur të licencuar për vlerësimin e pasurisë. Diferenca ndërmjet vlerës që rezulton nga rivlerësimi me vlerën kontabël të pasurisë, reflektohet në pasqyrat financiare të vitit 2020.

4) Peronat juridikë për këtë vlerësim paguajnë 5% të diferencës ndërmjet vlerës së rivlerësimit dhe vlerës kontabël të regjistruar për pasuritë e paluajtshme. Për qëllim të zbatimit të këtij neni personi juridik mban një kartelë të pasurisë së paluajtshme ku evidenton vlerën përkatëse të pasurisë së paluajtshme që nga momenti i njohjes fillestare të aktivitetit dhe tatimit përkatës të paguar sipas legjislacionit në fuqi. Diferenca ndërmjet vlerës së rivlerësimit dhe vlerës kontabël të regjistruar nuk është objekt amortizimi për qëllime tatimore”.

Ju falënderoj për mirëkuptimin!
Kush është pro në tërësi me të gjitha këto ndryshime? Kundër? Nuk ka, Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.
Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë më, 13.12.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi nen per nen i projektligjit “Per Buxhetin e vitit 2020”

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Arben Elezi, Evis Kushi, Anastas Angjeli, Suzana Topi,
Reme Lala, Ervin Bushati, Blerina Gjylameti, , Xhavit Bushaj, Roland Xhelilaj, Senida
Mesi, Vullnet Sinaj, Eljo Hysko, Edlira Hyseni, Artur Roshi, Krenar Ryçi, Korab Lita,
Ylli Shehu.

Mungojnë:

Antoneta Dhima,

Te ftuar

Ministria e Financave dhe Ekonomise

13. Zv/Ministri Z. Elton Haxhi
14. Z. Nikolla Lera Drejtor I Pergjithshem
15. Znj. Mimoza Dhembli Drejtoreshe e Pergjithshme e Buxhetit,
16. Znj. Suzana Stefa Drejtoreshe e Investimeve Publike,
17. Z. Gentian Opre Drejtor I Analizës dhe Programimit Buxhetor,
18. Z. Fran Brahimi Drejtor i Financave Vendore,
19. Znj. Ina Dhaskali P/sektori tek Programimi Buxhetor,
20. Znj. Vilma Causholli P/sektori tek Analiza Buxhetore.
21. Enkeleda Pipa
22. Enkeleda Kuci
23. Dorjana Toro
24. Ilir Sallaku

Arben Ahmetaj – Kalojmë të buxheti i shtetit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Thashë që do ta bëjë gati shërbimi i Kuvendit, se kemi punuar deri vonë, kështu që ju
kërkojmë ndjesë, por unë do t’i lexoj në detaje të gjitha.

Ju mund t’i merrni edhe të regjistruara, përveç kopjes.

Do ta mbarojmë sot, se pak gjëra kemi.

Kalojmë në diskutimin nen për nen të buxhetit shtetit 2020.

Pranë Komisionit për Ekonominë dhe Financat janë paraqitur raportet e komisioneve të tjera të përshërshme të Kuvendit për shqyrtim nen për nen dhe në tërësi të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020”. Në këto raporte pasqyrohet se në secilin komision projektbuxheti është miratuar nen për nen dhe në tërësi. Disa komisione kanë propozuar ndryshime në shpenzimet e parashikuara për vitin 2020 për ministrinë dhe institucionet në varësi të tyre, duke dhënë edhe argumente mbështetëse. Gjithashtu pranë Komisionit për Ekonominë dhe Financat janë paraqitur disa propozime të argumentuara për ndryshime në projektbuxhetet nga Byroja e Kuvendit, KLSH-ja dhe iu referuam edhe Prokurorisë së Përgjithshme (me nr. 60), duke u nisur nga situata aktuale, e cila kërkon marrjen e masave financiare për përballimin e dëmeve dhe pasojave të tërmetit të nëntorit të këtij viti, projektbuxheti do të kërkojë ndryshime të rëndësishme në numra dhe në materie, por edhe në filozofi, ku vendin kryesor e zë krijimi i fondit të rindërtimit.

Ky fond parashikohet të jetë 20 miliardë lekë për vitin 2020, nga të cilat 13 miliardë lekë do të financohen nga buxheti i shtetit, pra nga burimet e brendshme duhet thënë, dhe 7 miliardë lekë do të financohen nga donatorët. Ky fond (dhe do të reflektohet dhe në nenin specifik për këtë fond) mund të rritet gjatë vitit në rast se rriten donacionet që kanë për qëllim rindërtimin e vendit. Për këtë arsye do të reflektohet në të ardhurat nga grantet sipër dhe në shpenzimet brenda fondit.

Moza, jemi dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull.

Ky fond do të trashëgohet vitin pasardhës, me qëllim mbulimin e të gjitha kostove të mundshme të pasojave të tërmetit, qoftë pjesa e granteve, qoftë pjesa e financimit të brendshëm.

Në kuadër të masave financiare të ndërmarra për shkak të tërmetit, në projektbuxhetin e vitit 2020 parashikohet, gjithashtu, të shtohet edhe një fond prej 1,2 miliardë lekësh për programin “Strehimi” brenda Ministrisë së Financave për bonusin e qirave, në mënyrë që maxhoranca t’u garantojë strehimin gjatë gjithë periudhës familjeve që kanë humbur banesat në mënyrë të pakthyeshme, i cili do të gjenerohet nga reduktimi në të njëjtën masë i disa shpenzimeve, pa prekur fondin e rindërtimit.

Ndërkohë, siç e theksuam, në rakordim të plotë me Kryeministrin e vendit, vlera 6,2 miliardë e sjellë nga ju për projekte të reja riformatohet dhe riformatimin e keni të detajuar më pas.

Pra, nga 6,2-miliardëshi nuk preken investimet e reja në shëndetësi, u referohem këtu qendrave shëndetësore, kurse pjesa tjetër rialokohet më pas, që do ta diskutojmë.

Të gjitha propozimet e paraqitura nga komisioni dhe institucionet buxhetore u analizuan nga një grup teknik pune, si dhe u konsultuan me përfaqësuesit e Ministrisë së Financave për të parë mundësinë e mbulimit me burimet e nevojshme buxhetore.

Në përfundim të këtij procesi, i propozoj komisionit që të miratojë një pjesë të propozimeve. Për propozimet e paplotësuara rekomandoj që nevojat më të domosdoshme të përballohen nga fondi i parashikuar në projektbuxhet, duke rritur efektivitetin e përdorimit të fondeve në dispozicion.

Do t'ju lutesha që t'i ndiqnit një nga një, sepse janë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do t'ju vijë, patjetër, madje ndjesë, sepse është punuar deri vonë.

Në përfundim, i propozoj komisionit që në projektligjin e buxhetit për vitin 2020 të bëhen ndryshimet si më poshtë. Do t'u lutesha shërbimeve të Kuvendit që t'i regjistrojnë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Zëvendësministër! Zonja drejtoreshë, ju lutem!

Në nenet e projektligjit shtohet një nen me këtë përmbajtje: “Neni i rindërtimit. Fondi i rindërtimit prej 20 miliardë lekësh, i cili përdoret për përballimin e pasojave dhe të dëmeve të tërmetit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem tani, se po kalojmë buxhetin e shtetit! Muhabete koti!

“Fondi i rindërtimit prej 20 miliardë lekësh, i cili përdoret për përballimin e pasojave dhe të dëmeve të tërmetit të vitit 2019 përbëhet nga grante 7 miliardë, shpenzime të buxhetit të shtetit 13 miliardë. Fondi prej 20 miliardë lekësh i tejkalon kufijtë e shpenzimeve buxhetore për çdo ministri dhe program buxhetor të miratuar në tabelën nr. 1 të nenit 10 të këtij ligji (pra është program më vete). Çdo e ardhur në formë granti me destinacion përballimin e pasojave dhe dëmeve të tërmetit mbi tavanin prej 7 miliardë lekësh rrit në të njëjtën masë të ardhurat dhe shpenzimet e fondit të rindërtimit”. Kjo është shumë e rëndësishme, Moza, Toni, pasi nuk preket financimi i brendshëm, por shtohet granti, duke shtuar kufijtë e miratuar në nenet 1, 2, 8 dhe 10, si dhe kufijtë e miratuar në tabelat 1 dhe 4 të nenit 10 të këtij ligji.

“Në fund të vitit buxhetor, fondet e pashpenzuara trashëgohen vitin pasardhës dhe përdoren për të njëjtin qëllim brenda të njëjtit program. Mënyra e përdorimit të fondit të rindërtimit, programet buxhetore ku do të alokohet, si dhe institucionet dhe agjencitë zbatuese të tij, vendore ose qendrore, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Krijohet fondi i rindërtimit në vlerën 20 miliardë lekë. Siç e theksova, riallokohen shpenzimet kapitale prej 6 miliardësh, të cilave iu referuam nga projektet e reja; shtohen shpenzime, të cilat do të riallokohen nga Ministria e Infrastrukturës në shpenzime kapitale dhe në shpenzimet e mirëmbajtjes operative (602 ose 604), në varësi të vendimmarrjes së ministres së Infrastrukturës në vlerën 3 miliardë lekë, ndërkohë 2,5 miliardë lekë janë shpenzime kapitale (thotë këtu, por këtë do ta negocioni me ministrinë); 0,5 miliardë lekë shpenzime korrente; shtohen shpenzimet në Fondin Shqiptar të Zhvillimit me 1,5 miliardë në lekë, në bazë të...”. Besoj se janë të gjitha investime, apo jo, Moza?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull.

Janë shpenzime kapitale, apo jo?

“3. Shtohen shpenzimet kapitale në Ministrinë e Bujqësisë me 0,5 miliardë lekë për mirëmbajtjen e digave; shtohen shpenzimet korrente të Ministrisë së Financave në programin “Strehimi” me vlerë 1,2 miliardë lekë (i referuam bonusit të strehimit për qytetarët që i kanë humbur shtëpitë në mënyrë të pakthyeshme nga dëmet e tërmetit).

4. Bëhen disa riallokime ndërmjet programeve dhe shpenzimeve korrente dhe kapitale, sipas tabelës përkatëse bashkëlidhur (t’u vihet në dispozicion të gjithëve kur të mbarojë tabela). Bëhen disa shtesa në institucionet si më poshtë: në projektbuxhetin e Kuvendit bëhen këto ndryshime. Shtohen 2 punonjës në organikën e administratës së Kuvendit, shtohen shpenzimet korrente në vlerën 74 milionë, dakord, Moza, lekë; shtohen shpenzimet kapitale me vlerën 180 milionë lekë për sallën e Kuvendit për ta restauruar, për të vënë sistemin antizjarr e të tjera”.

Ramë dakord që në Prokurorinë e Përgjithshme të shtohet ai numër punonjësish. Në Kontrollin e Lartë të Shtetit shtohen 7 punonjës dhe fondi përkatës.

Në programin “Shërbimi për diasporën” bëhen këto ndryshime: pakësohen shpenzimet kapitale me financim të huaj në vlerën 19 milionë lekë, shtohen shpenzimet me financim të brendshëm me të njëjtën vlerë dhe t’i hartohen programet e kërkuara nga ministri Majko siç i ka kërkuar të katra ose të gjashta programet.

Dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull, katër programe.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Së dyti, siç e thashë, detajohet buxheti i shërbimit për diasporën, sipas institucioneve respektive dhe sipas tabelës së bashkëngjitur.

Në buxhetin vendor bëhen këto ndryshime.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni! Në tabelën 3, në kolonën shtesë nga Kuvendi, shtohen transfertat e pakushtëzuara në disa bashki me 200 milionë lekë, sipas tabelës bashkëlidhur.

Në tabelën 3, në kolonën shtesë nga Kuvendi, shtohet transferta specifike për shpenzime kapitale për rrugët me 200 milionë lekë, sipas tabelës bashkëlidhur.

Në transfertën e pakushtëzuar sektoriale, në kolonën “Mbrojtja sociale”, shtohen shpenzimet me vlerën 26 milionë lekë për qendrën sociale “Horizont”, të cilat i zbriten Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Ky ndryshim pasqyrohet në aneksin nr. 4 të projektligjit.

Siç e theksova, Kontrollit të Lartë të Shtetit i shtohen 7 punonjës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni, se janë të rëndësishme!

Siç e theksova, Kontrollit të Lartë të Shtetit i shtohen 7 punonjës dhe shpenzimet e personelit me 7 milionë lekë; Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi i shtohen 2 punonjës në organikë; Arkivit të Shtetit i shtohen shpenzimet kapitale në vlerën 20 milionë lekë.

Të gjitha ndryshimet e mësipërme të reflektohen në tabelat dhe në nenet e projektligjit.

Kush është pro ndryshimeve? Kundër?

Kalojnë të gjitha propozimet e komisionit.

Kalojmë nen për nen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, po, do të më sugjeroni vetë se ku do ta vendosni nenin e rindërtimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, neni i parë është tjetër gjë.

Anastas Angjeli – Te neni 1 janë të ardhurat dhe shpenzimet.

Arben Ahmetaj – Po.

Atëherë, kreu “Buxheti”.

Neni 1. Kush është dakord me nenin 1, me të gjitha ndryshimet që u votuan nga komisioni, që do të reflektohen tek të ardhurat dhe shpenzimet? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 1 me të gjitha ndryshimet të cilave iu referova për çfarë i takon nenit 1. Kjo do të ndodhë për të gjitha nenet, ndërsa nenin specifik për rindërtimin do ta rilexojmë përsëri këtu dhe do të ma numëroni ju. Pra, do të më thoni që ai nen do të jetë numri kaq, unë do ta lexoj për rekordet e Kuvendit, që t’i shkojë seancës ashtu siç do ta fjalëzojmë.

Neni 2.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, po, nen për nen buxhetin.

Neni 2. Kush është dakord me të gjitha ndryshimet që reflektuam? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Zoti Roshi, ishit kundër, apo pro, se ju kapi *in between*?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, zoti Roshi ishte kundër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, por të shoh duart!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fokus, ju lutem, se kemi buxhetin e shtetit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull.

Neni 3, me ndryshimet që kaluam në momentin e parë, të propozuara nga komisioni. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Keni votuar kundër pensioneve.

Neni 4. Kush është pro me nenin 4, me ndryshimet që ne aprovuam? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 5. Kush është pro të gjitha ndryshimeve që kaluam? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 6. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Për mediet, në cilësinë e kryetarit, theksoj që ky ishte neni i kompensimit në vlerë të ish-pronarëve. E djathta votoi kundër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Neni 7.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, të mbaroj!

Neni 7. Kush është pro?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ore, bëj çfarë të duash tani!

Artur Roshi – Jo, mor zotëri, se nuk je...

(Deputeti Roshi ndërhyr pa mikrofon.)

Arben Ahmetaj – Neni 7. Kush është pro me ndryshimet që kemi kaluar?

Artur Roshi – Fondi për ish-pronarët është qesharak, është marrë pambarimisht i vogël.

Këta duan të vazhdojnë gallatat në kurriz të tyre.

Arben Ahmetaj – Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kreu VIII.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Turi, në fund!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ta jap fjalën tani, por në fund!

Artur Roshi – Ne jemi kundër kacidheve që u jepni ish-pronarëve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Dakord.

Neni 8. Kush është pro me ndryshimet që kemi votuar?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, e drejtë. Kush është kundër?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, neni 7 do të jetë neni i rindërtimit, siç e lexuam.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe një herë, kush është pro nenit 7, që do të jetë programi i rindërtimit? Do të jetë programi i rindërtimit, jo fondi, se nuk është fond special.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonja Kushi, ju lutem!

Neni 7. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 8. Kush është pro me ndryshimet që do të reflektohen? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 9 “Kufiri i deficitit”. Kush është pro?

Moza, këtu do të duhet të reflektoni se si do të dalë në tabelë dhe lidhur me financimin e brendshëm, pra lejin që ka qeveria të dalë në tregun e brendshëm. Do ta reflektoni sot, në referencë të ndryshimeve që bëme në tabelën fiskale, por do të referohet edhe në nen. Pra, keni punë gjithë ditën për ta zbardhur. Në darkë do të ma jepni mua në dorë ta shoh në detaje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër. Pasi të jetë formëzuar, t’u kalohet të gjithë deputetëve që ta kenë në dorë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk është pjesë e ligjit, i dashur!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të tregoj që ç’ke me të, por, dakord, vazhdojmë!

Neni 9. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 10 “Shpenzimet”. Kush është pro me ndryshimet, duke referuar të gjitha ndryshimet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Anastas, të lutem!

Kush është pro me nenin 10? Kundër? Abstenim?

Miratohet neni 10.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Neni 11. Kush është pro? Do t’jua jap në fund, por ta votojmë të gjithin. Kundër? Abstenim?

Miratohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Numri me referimet që thamë për ndryshimet: po në prokurori, në KLSH, në Kuvend, tek antidiskriminimi e të tjera; ato që numëruam.

Kush është pro neni 10? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 12 “Paga e Presidentit”. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 13, me të gjitha ndryshimet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, është fikse, 257 mijë lekë në muaj dhe rritet gjatë viteve sipas përcaktimeve që miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave; siç ka qenë.

Neni 13. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër, do t’jua jap në fund!

Neni 14. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet neni 14.

Ju lutem, fokus, ju të Ministrisë së Financave!

Neni 15. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Pra, gjithmonë, zoti Zëvendësministër, zonja Drejtoreshë, reflektohen ndryshimet që aprovuam në momentin e parë.

Neni 16 “Kufiri i shpenzimeve”. Kush është pro me ndryshimet që referuam? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Te neni 16 referojuni “ministri përgjegjës për financat”, sepse mund të ndryshojnë emrat dhe ngelet buxheti pa zbatuar. Dakord, Moza?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Neni 17. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 18. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 19, për eurobondin. E keni shifrën.

Zoti Zëvendësministër, zonja Drejtoreshë, shifra është indikative, por duhet të përdorni një fjalë shqip që është orientuese, në mënyrë që ligjvënësi ta kuptojë se ajo mund të jetë 65, 60 ose edhe 70, sepse do të vini me ligj të veçantë, gjithsesi, për eurobondin. Kështu që...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po.

Neni 19. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 20. Edhe këtu kemi ndryshimin “Ngarkohet ministria përgjegjëse për financat”. Kush është pro nenit 20? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 21 “Hyrja në fuqi”. Kush është pro?

Jo, këtu jo, sepse duhet të hyjë buxheti që nga data 1 janar.

Do t’i marrim leje Presidentit.

Kundër? Abstenim?

Miratohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk ia rritëm rrogën Presidentit, është aq sa ka qenë!

Askujt nuk i është rritur rroga; zero!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E vërteta është fakti që nuk është.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Korab, merr frymë thellë!

Neni 21: “Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar i vitit 2020”. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Hedhim në votim në tërësi projektligjin “Për buxhetin e vitit 2020”, nuk kemi nevojë ta themi numrin e ligjit. Kush është pro në tërësi?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Faleminderit, zoti Roshi! Kush është kundër? Abstenim?

Miratohet.

(Duartrokitje)

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti